

NOEU

PLANI I SHPËTIMIT

TREGIMI NGA CARINE MACKENZIE
ILUSTRIMET NGA FRED APPS



© Carine Mackenzie, 1999

Reprinted 2004, 2007, 2013, 2017

Published by ChristianFocusPublications, GeaniesHouse, Fearn,
Tian, Ross-shire, IV20 1 TW, Scotland, U.K.

www.christianfocus.com

Përkthyer në gjuhën shqipe nga ZGG-ALBANIA, 2019

Përkthyer nga: Migena Ramaj Adamou


Redaktuar nga: Mirela Zefi, Erion Ramaj

Koordinatorë: Willemien van Schothorst

Noeu ishte një njeri i drejtë dhe i mirë. Ai i sillte nder dhe gëzim Perëndisë me mënyrën se si jetonte. Noeu dhe gruaja e tij patën tre djem: Semin, Kamin dhe Jafetin.








Por njerëzit rreth e qark Noeut nuk ishin si ai. Ata ishin të ligj dhe të dhunshëm. Ata nuk donin t'ia dinin për Perëndinë. Gjatë gjithë kohës mendonin vetëm për gjëra të mbrapshta. Ligësia e tyre ishte aq e madhe, saqë Perëndia u pendua që i kishte krijuar.

"Do ta shkatërroj këtë botë e cila është plot e përplot me dhunë", tha Ai.

Por Perëndia nuk dëshironte të lëndonte Noeun e mirë dhe familjen e tij, ndaj i lajmëroi ata dhe u dha një mesazh.





"Ndërto një arkë të madhe", i tha Perëndia Noeut.

"Do të dërgoj një përmbytje në tokë për të shkatërruar të gjithë njerëzit e ligj, por pretoj të të mbaj ty dhe familjen tënde të sigurt brenda saj."

Noeu besoi në atë që Perëndia i tha dhe iu bind udhëzimeve të Tij.





Perëndia i dha Noeut udhëzime të hollësishme për të ndërtuar varkën e madhe (e quajtur ndryshe edhe arkë). Noeu ndoqi çdo udhëzim deri në detaje.

Ishte një detyrë gjigande! Një arkë prej 140 metrashe gjatë, 23 metra e gjerë dhe 14 metra e lartë, e ndërtuar me drurë të mirë e të përzgjedhur dhe e lyer me bitum nga brenda që të mos lejonte të hynte uji. Në maj kishte një çati, ndërsa në njërin krah kishte një derë. Një hapësirë rreth gjysmë metri u krijua mes anëve dhe çatisë, pasi kjo do të lejonte qarkullimin e ajrit të freskët.

Noeu ndërtoi një arkë me tre kate dhe me dhoma për familjen e tij.





Perëndia i tha Noeut që të merrte çdo lloj kafshe në arkë, dy nga secili lloj, një mashkull dhe një femër për t'i shpëtuar nga përmbytja. Në arkë duhet të kishte gjithashtu ushqim të mjaftueshëm për t'i ushqyer ata për një kohë të gjatë. Noeut iu desh të merrte shtatë çifte të disa kafshëve: ato që ishin të nevojshme për ushqim, ato që do të përdoreshin për sakrificë dhe shtatë çifte nga zogjtë e qiellit.




Pas shumë vitesh pune të vështirë, ndërtimi i arkës përfundoi. Noeu iu bind çdo gjëje që i tha Perëndia dhe veproi saktësisht sipas urdhreve të Tij.





Noeu, gruaja e tij bashkë me Semin, Kamin, Jafetin dhe gratë e tyre, hynë në arkë. Të gjitha kafshët erdhën në radhë njëra pas tjetrës, ashtu siç kishte urdhëruar Perëndia. Zoti kishte premtuar që nuk do t'u ndodhte asgjë e keqe. Ata do të ishin të sigurt. Ai kishte siguruar planin e shpëtimit. Kur të gjithë hynë brenda dhe ishin të sigurt aty, Perëndia e mbylli derën e arkës.







Filloi një shi i fortë. Rrebeshi vazhdoi për ditë të tëra pa pushim. Për dyzet ditë ra shi mbi tokë dhe ujërat e përmytjes vinin gjithnjë e më lart. Arka u ngrit nga toka dhe filloi të lundronte mbi ujë. Ashtu siç kishte paralajmëruar Perëndia, çdo gjë e gjallë vdiq; njerëzit, kafshët, shpendët dhe zvarranikët.

Shpëtuan vetëm ata që ishin në arkë me Noeun.



Për 150 ditë radhazi, uji e përmyti tërësisht tokën. Por Perëndia nuk i kishte harruar Noeun dhe kafshët që ishin në arkë. Era filloi të frynte dhe të largonte ujin. Gradualisht ujërat e përmytjes u thanë dhe arka preku tokë të thatë në malet e Araratit.

Por kudo përreth kishte ende shumë ujë.





Dyzet ditë më vonë, Noeu hapi një dritare në arkë dhe lëshoi një korb dhe një pëllumb. Korbi fluturoi para dhe pas mbi ujë dhe nuk u kthye në arkë. Pëllumbi kërkoi vend të thatë, por nuk arriti të gjente dhe u kthye tek Noeu.

Noeu shtriu dorën e tij, e mori pëllumbin dhe e futi brenda në arkë.









Pasi kaluan shtatë ditë të tjera, Noeu e lëshoi pëllumbin sërish. Këtë herë pëllumbi u kthye në mbrëmje me një gjethe ulliri në sqep.

Noeu e kuptoi që niveli i ujit po ulej. Pemët tani dukeshin mbi sipërfaqen e ujërave.

Një javë më pas, kur pëllumbi u lëshua sërish, nuk u kthye më. Tani ai mund të jetonte në tokë.





Noeu priti njëzet e nëntë ditë dhe pastaj hapi derën e arkës. Ujërat e përmytjes ishin zhdukur. Pasi kaluan tetë javë të tjera, toka u tha tërësisht nga ujërat e përmytjes.

"Tani mund të dalësh nga arka!", i tha Perëndia Noeut. "Merr gruan tënde, bijtë e tu dhe gratë e tyre me vete. Nxirri jashtë gjithashtu të gjithë shpendët, kafshët dhe zvarranikët."



Noeu e adhuroi Perëndinë. Ai ndërtoi një altar dhe aty sakrifikoi kafshët që Perëndia i kishte thënë që ishin të përshtatshme për sakrificë. ZOTI ishte i kënaqur me Noeun dhe sakrificën e tij.

"Nuk do të lejoj më kurrë që toka të shkatërrohet tërësisht," premtoi Perëndia, "as kur njerëzit të bëjnë gjëra të tmerrshme!"





Perëndia bëri një premtim tjetër. "Për sa kohë të ekzistojë toka, do të ketë gjithmonë mbjellje dhe korre, të ftohtë dhe të nxehtë, verë dhe dimër, ditë dhe natë."

Tashmë Noeu dhe familja e tij mund ta fillonin punën në tokë, të rrisnin bimë, duke e ditur që Perëndia nuk do ta përmbyste më tokën plotësisht.

Perëndia e bekoi Noeun dhe bijtë e tij.

"Do të kesh shumë fëmijë, të cilët do të përhapen në gjithë botën dhe do të kesh pushtet mbi çdo gjallesë."

Perëndia i bëri një premtim të veçantë (të quajtur besëlidhje) Noeut dhe bijve të tij. "Kurrë më nuk do t'i shkatërroj të gjitha krijesat me përmbytje; kurrë më nuk do ta përmbys të gjithë tokën!"





Si shenjë premtimi, Perëndia i tregoi ylberin në qiell. Ai i tha Noeut: "Sa herë që të shikoni një ylber në re, do të jetë si shenjë e besëlidhjes dhe e premtimit mes Meje dhe teje dhe çdo gjallese mbi tokë".

Noeu gjeti strehë dhe shpëtoi nga zemërimi i Perëndisë ndaj mëkatit dhe ligësisë, sepse iu bind Fjalës së Perëndisë. Ai i besoi Zotit dhe hyri në arkë. Perëndia na ka dhënë një vend sigurie, larg nga zemërimi i Tij ndaj mëkatit, nëse i bindemi Fjalës së Tij dhe i besojmë Zotit Jezus Krisht. Ai është vendi ynë i sigurisë.





Tani e tutje, sa herë që të shihni
një ylber, kujtoni që premtimet
e Perëndisë janë të vërteta dhe
besnike.

